



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT

NJOFTIM PER SHTYP

Zëvendës drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, z. Helidon Bendo, mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, zhvilluar nën drejtimin e Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta.

Në fjalën e tij në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, z. Bendo theksoi angazhimin maksimal të Shërbimit Informativ të Shtetit në përmbushjen e misionit si organ informativ, në funksion të sigurisë kombëtare.

KABINETI
Tiranë, më 17.05.2018